



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr. 02-060/01-0028628-1/23 dt. 20.04.2023
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 17

Koha: 20.04.2023 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri
Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Drejtorët e Drejtorive
Mungoi: Hysen Muzliukaj

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; neni 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komonale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e shtatëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me e-mail ju ka ardhur edhe Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023, që propozoj të hyjë në rend dite para raporteve të drejtorive.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Fadil Veseli: Jemi në prag të festës së Bajramit, propozoj që raportet e drejtorive pasi nuk ka ndonjë urgjencë të shtyhen për mbledhjen e radhës.

Vesel Neziri: Propozoj që pika 2) Projekt-rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut; të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse është një pikë e ndjeshme dhe mungon kostoja financiare e saj.

Kryesuesja vuri në votim propozimin që në rend dite të hyjë Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimitisht (7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime) vendosi që në rend dite të hyjë Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023.

Kryesuesja vuri në votim propozimin që pika 2) Projekt-rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të hiqet nga rendi i ditës dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar të kërkohej kostoja e saj.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime) vendosi që të hiqet nga rendi i ditës Projekt-rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Kryesuesja vuri në votim propozimin që nga rendi i ditës të hiqen raportet e drejtorive (pikat: 9-15.3).

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime) vendosi që të hiqen nga rendi i ditës raportet e drejtorive (pikat: 9-15.3).

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kodi i Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut
3. Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa procedurë konkurrimi
4. Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Agjencionin Kosovar për Inteligjencë, pa procedurë konkurrimi
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Gëzim Mikullovc
6. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Ali Emini
7. Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare
8. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e 16 u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kodin e Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Vesel Neziri: Kodi i Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut është obligim ligjor, prandaj duhet ta miratojmë, i njëjti është punuar mirë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Kodin e Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kodi i Etikës së Komunës së Mitrovicës së Jugut u miratua unanimisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja para se të hap diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa procedurë konkurrimi, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të Propozim-vendimit nga Kryetari i Komunës, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e mbledhjes e vuri në votim Propozim-vendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa procedurë konkurrimi.

Propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, pa procedurë konkurrimi u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pikat 4

Kryesuesja para se të hap diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Agjencionin Kosovar për Inteligjencë, pa procedurë konkurrimi, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të Propozim-vendimit nga Kryetari i Komunës, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e mbledhjes e vuri në votim Propozim-vendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Agjencionin Kosovar për Inteligjencë, pa procedurë konkurrimi.

Propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Agjencionin Kosovar për Inteligjencë, pa procedurë konkurrimi u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5 dhe 6

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me: Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajjtshme të Komunës me pronën e paluajjtshme në pronësi private të personit fizik Gëzim Mikullovc; dhe Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajjtshme të Komunës me pronën e paluajjtshme në pronësi private të personit fizik Ali Emmini, për t'i arsyetuar të njëjtit fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të propozim-vendimeve nga Kryetari i Komunës, Kryesuesja e mbledhjes fjalën ia kaloi Drejtorit të DGJKP-së z. Artan Berisha.

Artan Berisha: Duke e parë të arsyeshme dhe jetike hapjen e rrugës "Ali Zeneli" si njëra prej rrugëve më me prioritet në komunën tonë ne kemi sjellë tek ju propozim-vendimin për hapjen e kësaj rruge, do të këmbehen 2 prona me pronarë të ndryshëm P-71208072-01445-1 në sipërfaqe prej S=898m², në pronësi të Komunës me vendndodhje "Kej Lushtë", me Parcelën Kadastrale P-71208072-01289-2 me sipërfaqe S=249 m², në pronësi të Ali Emmini dhe Parcela Kadastrale P-71208072-01287-0 me sipërfaqe S=115 m², në pronësi të Gëzim Mikullovcit me vendndodhje tek sheshi i tregut, në këto prona ekzistojnë objekte banimi dhe afarizëm, ku është bërë vlerësimi nga Ministria e Ekonomikë, konkretisht nga Zyra e tatimit në pronë. Prandaj ne kemi proceduar këto propozim-vendime konform ligjeve në fuqi.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e mbledhjes e vuri në votim Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajjtshme të Komunës me pronën e paluajjtshme në pronësi private të personit fizik Gëzim Mikullovc.

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajjtshme të Komunës me pronën e paluajjtshme në pronësi private të personit fizik Gëzim Mikullovc u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.



Kryesuesja e mbledhjes e vuri në votim Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Ali Emini.

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik Ali Emini u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 7

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të Kërkesës nga ana e Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e mbledhjes e vuri në votim Kërkesën për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare.

Kërkesa për transfer dhe rialokim të mjeteve financiare u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 8

Kryesuesja e mbledhjes para se të hap diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-mars 2023, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të Raportit nga ana e Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Sa i përket raportit financiar, po fillojmë me të hyrat vetanake, gjendja nuk është e kënaqshme, dihet se Qeveria deri në fund të marsit nuk alokon mjete për investimet kapitale, dhe çdo herë mbetet një hap mbrapa Komuna me realizim. Te çështja e investimeve kapitale iu sugjerojë të gjitha drejtorive të jenë shumë të kujdesëm dhe të gjitha projektet që ata e shohin se nuk ka mundësi të realizohen këtë vit të barten mjetet aty ku mund të realizohen, se përndryshe ikë ai investim. Ministria e Financave sa i përket tatimit në pronë, ka krijuar një mjegull që as ekspertët më të mëdhenj të financave nuk po e kuptojnë se lere më qytetarët, a është duke e bërë këtë me qëllim a pa qëllim ne nuk e dimë, por të gjithë qytetarët e Mitrovicës po dëmtohen. Shtylla e financimit të Komunës është tatimi në pronë, dhe nëse këtu goditet Komuna, realizimi i investimeve kapitale vështirësohet dhe kjo është tepër shqetësuese. Te raporti financiar çështje pozitive është se nëse bëhet krahasimi me vitin e kaluar, te mjetet që merren përmes përmbarusit vërehet se kemi një shkallë shumë më solide dhe më të përshtatshme.

Vesil Neziri: Nëse falja e një pjese të tatimit në pronë bëhet për të mirën e qytetarëve, atëherë ato mjete Qeveria duhet t'ia bartë Komunës, sepse mjetet e mia financiare nuk mundet askush t'i falë askujt sepse dëmtohem unë. Sa i përket realizimit të projekteve ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse puna e realizimit të projekteve është maratonë, ekzekutivi duhet ta vazhdojë maratonën dhe të arrijë në fund të vitit realizimin e projekteve të parapara.

Xhylyeta Imeri: Do të ndalem tek inkasimi i të hyrave vetanake, sipas të dhënave që i kemi janë larg planifikimit, edhe në krahasim me vitin 2022 në përgjithësi të hyrat janë shumë më të ulëta sesa që kanë qenë në vitin e kaluar, përveç te Mirëqenia Sociale, Buxhet e Financa, QKMF-ja, Çerdhja, SHM "Hasan Prishtina" dhe SHM "Arkitekt Sinani" kanë një inkasim më të lartë në krahasim me vitin 2022, kurse të tjerat në përgjithësi janë më të ulëta, por presim dhe shpresojmë se në muajt në vazhdim do të kemi inkasim më të lartë të të hyrave vetanake.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2023.

Raporti financiar për periudhën janar-mars 2023 u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:26 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI



Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

